



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:051909  
Datë: 31.12.2024  
Numri i dokumentit: 06671582

**C.nr.2927/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.M. nga Skenderaj, i përfaqësuar sipas autorizimit nga J.O., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës N.P.Q.P.K. Sh.A. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga L.G., avokat nga zyra e avokatisë “S.L.C.” Sh.P.K., me objekt kontesti anulim i vendimit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik e mbajtur në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa me datë 31.12.2024, e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit B.M. nga Skenderaj me të cilën ka kërkuar që të ANULOHET në tërësi Vendimi 02/2020 i datës 10.04.2020 me numër protokollit 01-719/2020 i datës 14.04.2020 i marr nga N.P.Q.P.K. Sh. A. si i kundërligjshëm dhe të OBLIGOHET e paditura N.P.Q.P.K. Sh. A., që paditësin të kthejë në pozitën e tij paraprake Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit ose pozitë tjetër ekuivalente me të, të OBLIGOHET e paditura N.P.Q.P.K. Sh.A. që në emër të kompensimit të demit në formën e pagave të përcaktuara prej datës 10.04.2020 deri në datën e përpilimit të ekspertizës financiare me datë 23.05.2024, t’i paguaj paditësit shumën neto prej 71,642.84 euro, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën 6726.98 euro, në emër të kontributit pensional nga punëdhënësi shumën prej 4124.73 euro, në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 4124.73 euro, e të gjitha këto në shumën e tërësishme bruto prej 82,494.55 euro, të OBLIGOHET e paditura që nga data e përpilimit të ekspertizës 23.05.2024 e deri në ekzekutimin e këtij aktgjykimi t’i paguaj paditësit për çdo muaj pagën bruto prej 1660.00 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur që nga arritja e pagesës së çdo page veç e veç që nga data 10.04.2020, e deri në ekzekutimin e këtij aktgjykimi.

**II.** Detyrohet paditësi B.M. nga Skenderaj t’ia paguaj të paditurës N.P.Q.P.K. Sh. A. me seli në Prishtinë, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,155.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 13.05.2020, gjatë seancave në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura në pozitën e punës Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit deri me datë 10.04.2020, kur me vendimin 02/2020 i datës 10.04.2020 me numër

të protokollit 01-719-20202 i datës 14.04.2020 Bordi i Përkohshëm i të paditurës i ndërpret kontratën e punës. Ka shtuar se, vendimi 02/2020 i datës 10.04.2020 është i kundërligjshëm dhe nuk qëndrojnë arsyet mbi bazën e të cilave i është shkëputur marrëdhënia e punës këtu paditësit, ky vendim i marr nga ana e Bordit të paditurës mbi bazën e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe raporteve të auditorit të të paditurës për vitet 2018 dhe 2019 dhe planifikimit të prokurimit për vitin 2020 nuk mund të qëndrojë si i ligjshëm, e aq me shumë kur këto raporte veçse janë analizuar nga Bordi paraprak i të paditurës, por edhe ngase lëshimet e cekura në këto raporte nuk mund t'i mvëshën pozitës që ka ushtruar paditësi pasi që kjo pozitë nuk ndërmerr i vetëm veprimet për eliminimin e të gjeturave në këto raporte të auditimit, pasi që edhe në bazë të detyrave të punës shihet se ZKFTTh menaxhon dhe vepron nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KSHE varësisht prej kufizimeve të këshillit të drejtove të Bordit të të paditurës. Ka shtuar se, veprimet të cilat kanë mund të ndërmerren nga ana e paditësit si ZKFTTh kanë qenë veprime të cilat janë ndërmarrë në kuadër të kompetencave dhe detyrave të tij të punës. Tutje ka theksuar se, vendimi 2020/1-1 me të cilin i ndërpritet marrëdhënia e punës këtu paditësit është marr edhe me shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për shkak se paditësit nuk i është mundësuar fare mbrojtja e të drejtës së tij pranë organeve administrative të të paditurës në mënyrën siç është përcaktuar edhe në kontratën e tij në nenet 13 dhe 14 por edhe në aktet normative të të paditurës, por edhe siç kërkohet në dispozitat e Ligjit të Punës i cili nuk është aplikuar fare me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës këtu paditësit. Ka shtuar se, Bordi i Drejtove të paditurës me rastin e marrjes së vendimit të atakuar fare nuk i jep mundësin paditësit që të bëjë mbrojtjen e së drejtës së tij pranë organeve të paditurës, nuk ka themeluar komision disiplinor për vërtetimin e gjendjes faktike dhe marrjes së një vendimi të ligjshëm pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante, duke mos i dhënë fare mundësinë e paraqitjes së mbrojtjes së tij të e paditura përmes ankesës ndaj këtij vendimi, por të njëjtin e udhëzon që të paraqes padi direkt në gjykatë dhe në këtë mënyrë paditësit i shkel të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ka shtuar se, me këto veprime të kundërligjshme dhe arbitrare të Bordit të të paditurës, me shkelje të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe ndryshimet e tij, shkelje të kodit të etikës për qeverisje korporative, me shkelje apo anashkalim të tërësishëm të ligjit të punës dhe akteve normative të vet të paditurës që rregullojnë çështjen e marrëdhënies së punës si dhe procedurave të parapara për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me këto akte si dhe me shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, paditësi konsideron se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë në kundërshtim me të gjitha procedurat ligjore dhe pa u respektuar asnjë nga dispozitat ligjore të ligjeve të lartcekura, veprime këto që vendimin e atakuar e bëjnë me tepër se të paligjshëm dhe me këtë vendim edhe i cenohet e drejta e tij e punës e mbrojtur edhe me nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës. Në seancën e shqyrtimit kryesor e ka precizuar kërkesën e padisë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, dhe nga gjykata ka kërkuar që e njëjta të aprovohet në tërësi e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208.00 euro, në emër të përpilimit të propozimit për caktimin e masës së sigurisë shumë prej 208.00 euro, për pesë seanca të mbajtura shumë prej 1350.00 euro, të llogaritura për secilën seancë nga 270.00 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 225.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 150.00 euro.

E paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në padi, në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se Vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës së paditësit ka ardhur bazuar në nenin 18 par. 1,2 dhe nenin 21, par. 1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike nr. 03-/L-087, si dhe plotësim ndryshimi i të njëjtit Ligj nr. 04/L-L-111, sipas të cilave dispozita parashihet mbikëqyrja e vazhdueshme dhe rigoroze e veprimtarisë së zyrtarëve të Ndërmarrjes Publike si dhe procedura e zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të zyrtarëve të lartë të Ndërmarrjes Publike. Ka shtuar se, mbështetur në këto dispozita ligjore Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve me rastin e shqyrtimit të raporteve të Zyrës Kombëtare të Audutimit (ZKA) për vitin 2018, raportet e auditimit nga Zyra e Auditimit të brendshëm për vitin 2019, si dhe planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2020, dhe konform këtyre të gjeturave ka qenë i obliguar që të ndërmarrë masa për përgjegjësinë zyrtare të paditësit sipas pozitës që ka pasur si Zyrtar i Lartë i Ndërmarrjes - Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit (ZKFTH) në PK sh.a. Tutje ka shtuar se, pretendimet e paditësit se kinse Vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës është i kundërligjshëm sepse është shkel Statuti i ndërmarrjes dhe kodi i etikës së qeverisjes korporative sa i përket agjendës dhe afateve të mbajtjes së mbledhjes së bordit të Drejtorëve, është i pa qëndrueshëm sepse sipas Procesverbalit të mbajtjes së takimit të datës 10.04.2020, është konstatuar nga paditësi dhe sekretari i kompanisë si person përgjegjës për organizimin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve se agjenda e takimit me të gjitha pikat e rendit të ditës është dërguar fillimisht me datë 04.04.2020, ndërkaq që më datë 07.04.2020 janë shtuar edhe dy pikat tjera në rend dite për mbledhjen e bordit të Drejtorëve e paraparë më datë 10.04.2020, me të cilët janë njoftuar të gjithë anëtarët e bordit të Drejtorëve përfshirë edhe paditësin si Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit (ZKFTH) dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve, duke shtuar se kjo vërteton faktin se agjenda me të gjitha pikat e rendit të ditës është dërguar me kohë dhe atë tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së Bordit të Drejtorëve më datë 10.04.2020. Tutje ka shtuar se, për të paditurën është i pa bazuar pretendimi i paditësit se kinse paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune tek e paditura edhe para se të emërohej në pozitën e Zyrtarit Kryesor të Financave dhe Thesarit (ZKFTH) dhe i njëjti kishte përvojë pune te e paditura, pasi që një fakt i tillë nuk është vërtetuar me asnjë provë dhe se paditësi ishte punësuar për here të parë në vitin 2012, në pozitën e Zyrtarit Kryesor të Financave dhe Thesarit (ZKFTH) në PK sh.a. dhe nuk ekziston asnjë provë që vërteton se i njëjti ishte i punësuar para se të emërohej në këtë pozitë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në padi shumë prej 208.00 euro, për pesë seanca të mbajtura shumë prej 1350.00 euro, dhe për pagesën e pjesëshme të ekspertizës financiare shumë prej 75.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1630.00 euro.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës e datës 18.02.2020 me numër 01-360/20, Vendimi numër 02/20 dt.10.04.2020, Vërtetimi i datës 29.08.2018 numër 03-183/18, Vendimi i datës 02.04.2020 numër 03/21, Agjenda numër 02/20 së bashku me e-malit e bashkangjitura, Procesverbali i bordit të përkohshëm numër 01/2020 i datës 10.04.2020, Formularët për vlerësimin e përfomances i datës 13.09.2017, i datës 27.06.2018, i datës

20.02.2020, dhe i datës 25.02.2019, Konkursi publik për vend pune i datës 29.05.2020 i shpallur nga e paditura, Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 NR.12-2014/20, Vendimi i datës 02.11.2012, Kontrata e punës numër 01-420/2012 e datës 08.12.2012, Raporti i auditimit të Ndërmarrjes Publike P.K. për vitin 2018, i datës 09.08.2018, Raporti përfundimtar i auditimit PK-06/DQN, Raporti përfundimtar i auditimit PK-04/DF, Raporti përfundimtar i auditimit PK-05, Raporti përfundimtar i auditimit PK-01/DO, Vendimi i Inspektoratit të Punës i datës 07.09.2020, Ekspertizat financiare e datës 16.04.2024 dhe plotësimet e saj të datës 18.04.2024 dhe të datës 23.05.2024, Regjistri për deklarimin e pasurisë, Vendimi numër 21/20 i datës 26.05.2020, Harmonizimi i gradave të stafit të PK SHA i datës 28.01.2021 dhe Vendimi i datës 29.01.2021 me nr. 01-183/21.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e refuzoj në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara rezulton se nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura në pozitën e punës Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit, fakt që konstatohet edhe nga kontrata në shkresa të lëndës. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës në mënyrë të njëanshme nga e paditura.

Kontestuese në mes të palëve në këtë çështje juridike kontestimore paraqitet ligjshmëria e Vendimit me numër 02/20 i datës 10.04.2020 i nxjerr nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve me të cilin vendim paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe kërkesat e tjera duke përfshirë kthimin në vendin e punës dhe pagesën e pagave të pa paguara nga momenti i ndërprerjes së kontratës.

Nga kontrata e punës e lidhur me kohë të caktuar me numër 01/360/20 e datës 18.02.2020 si dhe Vërtetimi me numër 03.1831/18 i datës 29.08.2018 të lëshuara nga e paditura, gjykata konstatoj se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura nga data 02.11.2012 në pozitën Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit.

Nga Vendimi me numër 02/20 i datës 10.04.2020, i protokolluar me datë 14.04.2020, gjykata konstatoj se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve te të paditurës NP "P.K." Sh. A. dhe me të njëjtin Vendim paditësi është udhëzuar të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditëve. Nga arsyetimi i këtij Vendimi, konstatohet se Bordi i Përkohshëm mbi bazën e raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018 dhe vitin 2019 si dhe planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2020, kishte gjetur se pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të NP P.K. Sh. A. për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

Nga procesverbali Nr. 01/2020 i datës 10.04.2020 i mbledhjes së Bordit të Përkohshëm, gjykata konstatoj se në këtë mbledhje paditësit përmes votimit nga anëtarët e Bordit i ndërpritet kontrata e punës, mbi bazën e raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, 2019 dhe 2020. Nga i njëjti procesverbal konstatohet se Bordi i Përkohshëm ka votuar me katër vota për ndërprerjen e kontratës së paditësit, nuk kishte abstenime, dhe kishte një votë kundër.

Nga Formularët e vlerësimit të performancës së paditësit, vlerësim ky i kryer nga Bordi i të paditurës për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, gjykata konstatoj se paditësi kishte vlerësim të shkëlqyeshëm të performancës.

Nga Vendimi me numër 01 Nr. 12-214/20 i datës 26.05.2020 i nxjerr nga Inspektorati i Punës, gjykata konstatoj se me këtë Vendim paditësit i është aprovuar ankesa, duke konstatuar se Vendimi i Bordit të Përkohshëm për ndërprerjen e kontratës së punës është në kundërshtim me Ligjin e Punës, dhe njëkohësisht duke e obliguar të paditurën P.K. që të anuloj këtë Vendim.

Nga Vendimi me numër të protokollit 405/2020 i datës 07.09.2020, gjykata konstatoj se Komisioni i Shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës, e kishte refuzuar të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe kishte vërtetuar Vendimin e shkallës së parë me numër 01 Nr. 12-214/20 i datës 26.05.2020.

Nga ekspertiza financiare, gjykata konstatoj se eksperti financiar ka kalkuluar të hyrat të cilat do t'i realizonte paditësi nga marrëdhënia e punës për periudhën 10.04.2020 deri me datën 23.05.2024, sipas së cilës paga bruto është në shumën prej 82,494.55 euro, paga neto në shumën prej 71,642.84 euro, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën 6726.98 euro, në emër të kontributit pensional nga punëdhënësi shumën prej 4124.73 euro, në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 4124.73 euro.

Nga provat e administruara dhe vlerësuara sikurse me lartë, gjykata konstatoj gjendjen faktike dhe atë se, paditësi ka qenë i punësuar në Postën e Kosovës Sh. A. nga data 02.11.2012 në pozitën Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit, se Bordi i Përkohshëm i të paditurës me Vendimin me numër 02/20 i datës 10.04.2020 pas votimit me katër vota për, asnjë abstenim dhe një votë kundër, paditësit i ka ndërprerë kontratën e punës, ligjshmëria e të cilit Vendim është objekt i vlerësimit në këtë çështje kontestuese.

Mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar sikurse me lartë, meqenëse kontesti në rastin konkret zhvillohet në mes të paditurës N.P.Q.P.K. Sh. A. e cila është kompani në pronësi publike, ndërsa pozita e punës së paditësit për të cilën i është ndërprerë kontrata e punës ka qenë Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit, gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili Ligj e rregullon mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së kontratës për pozitën Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit. Në lidhshmëri me këtë, Ligji i lartcekur në nenin 4 parasheh se të gjitha ndërmarrjet publike organizohen si shoqëri aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare, andaj në këtë rast gjykata do t'i referohet edhe Ligjit për Shoqëri Tregtare, marr për bazë faktin se e paditura e ka statusin e shoqërisë aksionare. Po ashtu, duke marr për bazë natyrën e kontestit, i cili ka të bëjë me ligjshmërinë e ndërprerjes së kontratës së punës, gjykata do t'i referohet edhe Ligjit të Punës.

Ligji për Ndërmarrjet Publike në nenin 18 paragraf 1 përcakton kompetencat e Bordit të Drejtorëve, sipas të cilët: *“Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së.”* Me tutje, i njëjti Ligj në nenin 21 paragraf 3 përcakton pozitat e domosdoshme të zyrtarëve për funksionim ndërmarrjes publike, ku njëra ndër to është edhe pozita e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit. Ndërsa i njëjti

nen, në paragrafin 1 parasheh se: *“Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarinimin e arsyes. Ky nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së.”* Sipas kësaj dispozite, Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike ka kompetencë ligjore që të emëroj zyrtaret, përfshirë edhe pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, gjithnjë sipas kësaj dispozite të njëjtit zyrtar shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë me shumicën e votave të ndërpresë kontratën e tyre duke dhënë arsye, apo edhe pa dhënë arsye. Po ashtu, me nenin 162 paragraf 1 të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare përcaktohen kompetencat në mënyrë të përgjithshme të Bordit të Drejtorëve, sipas së cilës: *“Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare”*. Nga kjo dispozitë del se Bordi i Drejtorëve është organi kryesor përgjegjës për marrjen e të gjitha vendimeve në kuadër të shoqërisë aksionare, pa përjashtuar edhe çështjet e punësimit. Me tutje, Ligji i Punës në nenin 2 paragraf 2 përcakton se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.”* Ndërsa i njëjti Ligj, në nenin 10 paragraf 7 parasheh: *“Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.”* Sipas kësaj dispozite, në rastet e lidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar, i njëjti i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet përcaktuara me Ligjin e Punës, por me përjashtimin nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj tjetër.

Nga analizimi dhe vlerësimi i dispozitave të lartcekura, gjykata vlerëson se Ligji për Ndërmarrje Publike në rastin konkret paraqitet si ligj special, kjo për faktin se i njëjti i rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, në raport me mënyrën e emërimit dhe ndërprerjes së kontratës për Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, e po ashtu, duke përcaktuar edhe kompetencat e Bordit të Drejtorëve të N.P. në raport me këtë pozitë. Meqenëse e paditura funksionon si shoqëri aksionare, kurse pozita e paditësit si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit paraqitet ndër pozitat kryesore, nga dispozitat e lartcekura del se kjo pozitë ka status të veçantë të rregullimit ligjor, duke i dhënë Bordi të Drejtorëve kompetenca të plota ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës, edhe pa deklarinimin e arsyes.

Duke qenë se Ligji për Ndërmarrjet Publike është ligj i zbatueshëm në rastin konkret, e duke marr për bazë autorizimet ligjore të cilat i janë bartur Bordit të Drejtorëve, i cili mundet sipas diskrecionit të tij në çdo kohë dhe me shumicë të votave të ndërpresë kontratën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit me ose pa deklarinimin e arsyes, e po ashtu, gjithnjë sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, duke marr për bazë faktin se, ky rregullim ligjor mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, gjykata konstatoj se Vendimi me numër 02/20 i datës 10.04.2020 i nxjerr nga Bordi i Përkohshëm i të paditurës, për ndërprerjen e kontratës së punës së paditësit në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, është vendim i ligjshëm i nxjerr në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Në lidhshmëri me konstatimet sikurse me lartë, duke u bazuar në faktin se paditësi nuk ka argumentuar se ndërprerja e kontratës së punës është bërë me shkelje ligjore, gjykata ka refuzuar

edhe kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësin të kthejë në pozitën e tij paraprake Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit ose pozitë tjetër ekuivalente me të, e po ashtu të obligohet që në emër të kompensimit të demit në formën e pagave të porealizuara prej datës 10.04.2020 deri në datën e përpilimit të ekspertizës financiare me datë 23.05.2024, t'i paguaj paditësit shumën neto prej 71,642.84 euro, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën 6726.98 euro, në emër të kontributit pensional nga punëdhënësi shumën prej 4124.73 euro, në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 4124.73 euro, e të gjitha këto në shumën e tërësishme bruto prej 82,494.55 euro, si dhe të obligohet e paditura që nga data e përpilimit të ekspertizës 23.05.2024 e deri në ekzekutimin e këtij aktgjykimi t'i paguaj paditësit për çdo muaj pagën bruto prej 1660.00 euro. Gjykata vlerëson se kërkesat nga marrëdhënia e punës janë të ndërlidhura në atë formë që, fillimisht duhet të provohet me prova se ka ndodhur shkelja e të drejtave të punëtorit, në rastin konkret ndërprerja e kontratës, e vetëm pasi të vërtetohet një shkelje e tillë e paditura mund të obligohet nga gjykata, për kthimin e paditësit në të njëjtën pozitë apo në një pozitë ekuivalente me të, dhe detyrimin për pagesën e kompensimit përkatës, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Në të njëjtën kohë, gjykata i analizoj dhe i vlerësoj edhe pretendimet e paditësit, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe të paqëndrueshme. Në raport me pretendimin se me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës nga e paditura nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës, në lidhshmëri me këtë pretendim gjykata e kishte parasysh edhe përmbajtjen e kontratës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, cila i referohet këtij ligji, si ligj i zbatueshëm, mirëpo siç është theksuar më lartë me nenin 2 paragraf 2 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.* Nga përmbajtja e kësaj dispozite, del se zbatimi i dispozitave të Ligjit të Punës, ka edhe përjashtime, dhe atë sikurse në rastin konkret ku Ligji për Ndërmarrje Publike si ligj special ka parashikuar zgjidhje për çështjen e caktuar që lidhet me emërimin dhe ndërprerjen e kontratës së zyrtarëve të ndërmarrjeve publike, përkatësisht pozitës së paditësit Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit. Në të njëjtën kohë, me nenin 21 paragraf 1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike parashihet se në raport me emërimin dhe ndërprerjen e kontratës së punës, kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe rrjedhimisht një pretendim i tillë i paditësit për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës, në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës është i pa qëndrueshëm.

Kurse, në raport me pretendimin tjetër të paditësit se Bordi i Drejtoreve të paditurës me rastin e marrjes së vendimit të atakuar nuk i ka jep mundësin paditësit që të bëjë mbrojtjen e së drejtës së tij pranë organeve të paditurës, nuk ka themeluar komision disiplinor për vërtetimin e gjendjes faktike dhe marrjes së një vendimi të ligjshëm pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante, duke mos i dhënë fare mundësinë e paraqitjes së mbrojtjes së tij te e paditura përmes ankesës ndaj këtij vendimi, por të njëjtin e udhëzon që të paraqes padi direkt në gjykatë dhe në këtë mënyrë paditësit i shkel të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mirëpo, sipas vlerësimit të gjykatës një pretendim i tillë është i pa bazuar, kjo për faktin se, gjykata duke konstatuar sikurse me lartë se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili ligj nuk parasheh themelimin e komisionit disiplinor, apo zhvillimin e një

procedure të tillë, duke përcaktuar se ndërprerja e kontratës së punës nga Bordi mund të behët edhe pa arsye. Kurse në raport me pretendimin për mos dhënien e së drejtës së ankesës tek e paditura, gjykata vlerëson se e paditura duke funksionuar si shoqëri aksionare, ku Bordi i Drejtorëve është organi me i lartë menaxhues, dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë organ me të lartë brenda saj i cili do të trajtonte ankesën eventuale të paditësit. Po ashtu, një rregullim i tillë ligjor parashihet edhe me nenin 78 të Ligjit të Punës, sipas të cilit: *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”*, në rastin konkret organ me i lartë për shqyrtimin e ankesës eventuale të paditësit se sa Bordi i Përkohshëm nuk ka ekzistuar, dhe me të drejtë paditësi është udhëzuar që të ndjek procedurën gjyqësore.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e paditësit se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë në kundërshtim me të gjitha procedurat ligjore dhe dispozitat ligjore, veprime këto që vendimin e atakuar e bëjnë me tepër se të paligjshëm dhe me këtë vendim edhe i cenohet e drejta e tij e punës e mbrojtur edhe me nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës. Gjykata këtë pretendim të paditësit e vlerëson si të paqëndrueshëm, për faktin se dispozita kushtetuese në aspektin parimor e garanton të drejtën e punës, mirëpo kjo garanci i nënshtrohet dispozitave dhe rregullave ligjore, dhe në rastin konkret pozita e paditësit i nënshtrohet rregullimit ligjor në raport me detyrat dhe përgjegjësit e tij duke përfshirë edhe emërimin dhe shkarkimin e tij. Për me shumë, gjykata në këtë procedurë ka konstatuar se vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës së paditësit, ishte vendim i ligjshëm dhe në përputhje me dispozita ligjore, ndërsa në raport me nenin 49 të Kushtetutës, paditësi e gëzon të drejtën e punës në vende të tjera të punës sipas zgjedhjes së tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe Vendimin me numër 01 Nr. 12-214/20 i datës 26.05.2020 i nxjerr nga Inspektorati i Punës, përmes të cilit Vendim paditësit i është aprovuar ankesa, duke konstatuar se Vendimi i Bordit të Përkohshëm për ndërprerjen e kontratës së punës është në kundërshtim me Ligjin e Punës, dhe njëkohësisht duke e obliguar të paditurën P.K. që të anuloi këtë Vendim, si dhe Vendimin me numër të protokollit 405/2020 i datës 07.09.2020, i nxjerr nga Komisioni i Shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës, i cili e kishte refuzuar të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe kishte vërtetuar Vendimin e shkallës së parë me numër 01 Nr. 12-214/20 i datës 26.05.2020. Megjithatë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se paditësi i është drejtuar me ankesë inspektoratit të punës, dhe e njëjta ankesë i është aprovuar, nuk ka ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese. Kjo për faktin se i punësuari – këtu paditësi, bazuar në nenin 82 të Ligjit të Punës, ka të drejtë të paraqes ankesë tek Inspektorati i Punës, por vetëm për çështje që bien brenda kompetencave të Inspektoratit të Punës. Bazuar në nenin 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, kompetencat e këtij organi administrativ, janë mbikëqyrja e zbatimit të ligjit të punës lidhur me kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, duke përfshirë edhe zbatimin e dispozitave të ligjeve të tjera që rregullojnë materie nga marrëdhënia e punës, dhe për shkeljet eventuale të gjetura, ky organ ka të drejtën shqiptimit të gjobave tek punëdhënësit. Së këndejmi, kontestet e kthimit të punëtorëve në vendin e punës, realizimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera që derivojnë nga marrëdhënia e punës, janë kompetencë e gjykatës.



Gjykata e shqyrtoj dhe vlerësoj edhe ekspertizën financiare si dhe pretendimet e tjera të paditësit, por të njëjtat nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore.

Vendimin që pala paditëse t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 452 të LPK-së, sipas se cilës: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.”* Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për pjesëmarrje në katër seanca gjyqësore shumë prej 270.40 euro për seancë, si dhe për plotësimin e ekspertizës shumë prej 75.00 euro, e në shumë prej 1,155.00 euro. Ndërsa gjykata nuk i njohu shpenzimet e tjera të kërkuara nga e paditura lidhur me paraqitjen e përgjigjes në padi, për faktin e njëjta ishte paraqitur nga vet e paditura e jo përmes të autorizuarit të saj përkatësisht avokatit, po ashtu edhe shpenzimet e kërkuara edhe për një seancë më shumë, për faktin se e njëjta seancë nuk ishte mbajtur pa fajin e paditësit.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.2927/2020, me datën 31.12.2024**

**Gjyqtari**  
Argzon Muçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.